

## STATUTI

### SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ENBORI” Sh.p.k

#### NENI 1

Shoqëria është krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj në perputhje me normat e akt themelimit, këtij statuti, Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit ne fuqi të Republikes së Shqipërise.

Për sa mësipër ortaku shoqërise krijon statutin e shoqërisë si mëposhtë vijon:

#### EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

#### NENI 2

**Emri**

Emri i shoqërisë së themeluar do të jetë “**ENBORI**” Sh.p.k

#### NENI 3

**Selia**

Selia dhe veprimtaria e e shoqërise do të jene në adresën Rruga : "Loni Logori", pallati Miketa 2000, Astir , Tirane .

Shoqëria mund e ka të drejte të ndryshojë seline e saj si dhe të hape ose mbylle adresë dytësore si degë të saj.


#### NENI 4

**Objekti**

Ofrimin e te gjitha sherbimeve qe lidhen me "Call Center" dhe Contact Center duke perfshire edhe perpunimin e te dhenave te shoqerive te tjera dhe/ose enteve publike,ndermjetesim tregetare dhe marketing ne fushen e sherbimeve telematike dhe telefonike,veprimtarite e lidhura dhe te ngjashme me ato te renditura me siper, te bleje, te shese, te marre hua, te jape me qira te mira te tundshme e te patundshme dhe cdo gje tjeter te nevojshme e te vlefshme per realizimin e drejperdrejtë o te terthorte te qellimit te shoqerise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund: te kryeje, ne rruge ndihmese te gjitha aktivitetet tregetare, industriale, ato lidhur me te mirat e tundeshme ose te patundeshme (perjashtuar mbledhja e kursimeve) te dobishme dhe/ose te nevojshme,etj. te kryeje konsulenza dhe sherbime profesionale ne fushen tregtare, ligjore, procedura administrative, burime njerezore etj; te kryeje cdo aktivitet tregtar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper.

#### NENI 5

**Kohëzgjatja**



1

Veprimtaria e shoqërise eshte pa afat. Kjo kohëzgjatje mund të ndryshohet nga themeluesi i saj me vendim unanim.

### KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISE

#### NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërise është 10,000 (dhjete mijë) leke, i cili përbëhet nga kontributi i ortakut te vetem dhe ka 1 (një) kuote.

Pjesa takuese e ortakut themelues eshte:

- a) Z. Julian Hysenaj zoteron 100 % (njeqind përqind) te kuotës e të kapitalit, duke pasur ne pronesi një kuote.

#### NENI 7

Kapitali themeltar mund të shtohet ose zvogëlohet vetëm me vendim të ortakut. Shtimi apo zvogëlimi i kapitalit themeltar do të bëhet në varesi të rezultateve ekonomike e në perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

#### NENI 8

Ndryshimet e zotërimit dhe/ose përqindjes së kuotave, që ka ortaku themelues, behet sipas legjislacionit ne fuqi.

#### NENI 9

Ortaku mund të lëre peng, si barrë siguruese apo si garanci kuotat e zotëruara në këtë shoqëri vetëm pas marrjes së një vendimi unanim nga ana e asamblese se per gjithshme.

#### NENI 10

Forma ligjore e shoqerise: Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.)

Ndryshimet e zotërimit dhe/ose përqindjes së kuotave, që ka ortaku themelues, behet sipas legjislacionit ne fuqi.

#### NENI 11

#### **Transferimi kuotave**

Kuotat e kapitali themeltar, që ato përfaqësojnë, mund të transferohet me anë të shitjes dhurimit apo çdo mënyre tjeter të njojur nga legjislacioni Shqiptar vetëm më vendim unanim të ortakut. Bën perjashtim nga ky rregull vetëm kalimi me trashëgimi. Transferimi tek persona të tretë, shqiptar apo të huaj, i pjesëve të kapitalit dhe kuotës që ato përfaqësojnë, bëhet me vendim unanim të ortakut.

A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'J' or 'D'. To its right is a small number '2'.

## NENI 12

Shoqëria mund të kete dhe kontribute të tjera në natyre. Ketu përfshihen të gjitha sendet e paluajtshme në shërbim të shoqerise si dhe ato të luajtshme, te cilat kalojnë në pronesi të shoqerise.

## FONDET E SHOQERISE

### NENI 13

Shoqëria percakton si fonde elementët e mëposhtëm:

- 1) Fondi themeltar (qarkullues);
- 2) Fondi reservë;
- 3) Fonde të tjera që mund të jenë të nevojshme gjate veprimtarise së saj.

Madhësia e secilit fond përcaktohet mbi bazën e vendimit të Asamblesë së ortakëve, i cili merr vendim gjithashtu edhe për qellimin e perdorimit të tij.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV.

### NENI 14

Shoqeria ka si organe të saj:

- a) Asamblene e përgjithshme  
dhe
- b) Administratorin, si perfaqësues ligjor.

Renditja e mësiperme shpreh dhe hierarkine e organeve drejtuese të shoqërise.


### NENI 15

Administrator i shoqërise do jete Z. Julian Hysenaj.

E gjithe veprimtaria e shoqerise administrohet nga administratori në përputhje me statutin dhe legjislacionin ne fuqi.

### NENI 16

Administratori shoqërise ka ne kopetence të emerojë, si përfaqësues të shoqerise, vetëm punonjës të saj për realizimin e detyrave të rëndësishme ne interes të shoqërise. Kompetencat e personave të autorizuar përcaktohen ne aktin e autorizimit të posacëm. Për veprimtari si aplikime për vertetimet pranë organeve shtetërore, aplikime te çdo lloji pranë Qëndrës Kombetare të Biznesit, dorëzime bilancesh, aplikime të ndryshme pranë organeve tatimore mund të kryhen nga persona të tretë, jo punonjes te shoqerise, të pajisur me autorizim të posaçëm.



## NENI 17

Shoqëria nuk merr përsiper veprimet e pasojat që vijnë prej tyre, të kryera nga të autorizuarit në tejkalim të kompetencave të percaktuara ne autorizim.  
Ky rregull vlen dhe për Administratorin që tejkalon kompetencat që i janë dhënë nga ligji e nga ky statut.

## NENI 18

Veprimitaria e shoqërise, administrohet nga administratori në përputhje me statutin dhe legjislacionin ne fuqi.

## NENI 19

Administratori per shqyrtimin e bilancit vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe menyren e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabel, emeron një ose disa eksperte kontabel.

## ASAMBLEJA PERGJITHSHME


### NENI 20

#### Të drejtat dhe detyrimet

Asambleja është organi më i lartë vendimarrës i shoqërise. Vendimet e Asamblesë merren vetëm me unanimitet votash.

Asambleja ka si kompetencë:

- a) përcaktin e politikave tregetare të shoqërise,
- b) miratim e ndryshimeve të statutit,
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- ç) përcaktimin e kompetencave të administratorit në aktin e emerimit,
- d) përcaktimin e shpërbimit të administratorit, likujduesit dhe ekspertëve të fushave të ndryshme.
- dh) mbikqyrjen, zbatimin e politikave tregtare nga administratorët,
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, raporteve te ecurise se shoqerise,
- ë) zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit,
- f) shqyrtimin e bilancit vjetor, kuotat e fondevë të ndryshme dhe fitimin e realizuar,
- g) vendosjen për krijimin e filialeve, degeve ose përfaqesive të shoqërise si dhe për krijimin e shoqërive të përbashketa,
- gj) vendosjen për marrjen e kredive si dhe mbarimin e aktivitetit të shoqerise, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqerise vlerësohen me humbje,
- h) realizimin e marrdhënieve të rëndësishme financiare dhe ekonomike të shoqerise, me persona të tjere fizike ose juridike,
- i) emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit teknik të shoqërise, sipas drejtimeve të veprimtarise që do ushtroje shoqëria,
- l) riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërise,
- ll) përcakton çmimin e furnizimit të energjisë së prodhuar,
- j) emerimin e përfaqësuesve të shoqërise para gjykatës.



**NENI 21**  
**Mbledhja asamblesë së ortakëve**

Asambleja mblidhet sa here që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqerise, në rastet e percaktuara me ligj, por gjithmonë jo me pak se një here në vit.

Ajo thirret nga administratori ose ortaket e shoqërisë.

Thirja bëhet me shkresë ose nëpermjet postes elektronike zyrtare të ortakëve. Njostimi duhet të përbaje vendin, diten, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e ditës, e tu dërgohet ortakeve jo me vone se shtate dite para dates se parashikuar për mbledhje.

Ortaku mund të perfaqësohet në asamble, vete ose nga një person i autorizuar prej tij me prokurë, ose ortak tjetër.

**ADMINISTRATORI**

**NENI 22**  
**Kompetencat dhe kufizimet e Administratorit**

- Administratori shoqërise ka për detyre dhe si kufizim te kompetencave te tij si me poshte:
  - a) të punoje, drejtoje e organizojne në menyre të tille shoqerinë, që të sigurojnë suksesin e saj në veprimtarine ekonomiko-financiare që ajo kryen;
  - b) të ndjekin politikën tregtare të vendosur nga asambleja e ortakëve;
  - c) perfaqesojë shoqerinë tregtare në marredhëniet me të tretët;
  - ç) të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave administrative, shkresave e dokumentave privatë të shoqërise, e të librave kontabël të shoqërise;
  - d) të hartojeë e nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurisë së veprimtarise dhe vazhdimesine e saj, se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve dhe paraqitjen e këtyre dokumentave para asamblese se ortakëve per miratim;
  - dh) të kryejë regjistrimet dhe dergoje të dhenat e detyrueshme të shoqërise, siç parashikohet ne ligj, pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit;
  - e) të raportojë me shkrim çdo muaj para ortakut te vetem te shoqerise asamblese, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare;
  - ë) nënshkruan kontratat e punës me punemarrësit;
  - f) ndjek problemet e shoqërise në marrdhëniet me organet e ndryshme shteterore dhe me personat e tjere fizike e juridike;
  - g) lidh kontrata me të trete për interesa të shoqërisë, vetem miratimin me shkrim te asamblese;
  - gi) përfaqësimin e shoqërise para gjykatës;
  - j) miraton rregulloren e punës;
  - k) emeron specialist te fushave te ndryshme si drejtësia, ekonomia, financat etj. per perfaqësimin e shoqerise perpara gjykatave, organeve administrative, shoqerive te tjera private per realizimin dhe mbrojtjen e interesave te shoqerise;
  - l) mban pergjegjesi civile e financiare ne se shoqeria peson dem ekonomik dhe/ose paraqet fitim te munguar ne bilancet e veta per shkak te tij apo strukturave qe varen nga ai;
  - ll) te monitoroje te gjitha lajmet qe do shkruhen e do botohen ne internet, faqen zyrtare te shoqerise, media audiovizive te shoqerise ose te paleve te treta;



5

- m) te reagoje menjehere publikisht dhe prane organeve administrative nese shikon se keqperdoret emri i shoqerise, ortakeve, punonjesve apo vete administratorit te saj;
- n) te kontrolloje ne menyre specifike si dhe te mbaje perjegjesi personale per veprimtarine e punonjesve te shoqerise qe merren me hetimin, hartimin dhe publikimin e lajmeve;
- nj) te transferoje nga llogarite bankare te shoqerise drejt subjekteve te treta, vetem shumat e nevojshme per pagimin e taksave, tatimeve, pagave, sigurimeve shoqerore, faturave tatimore te konfirmuara se jane te vlefshme per shoqerine;
- o) te mbaje perjegjesi civile e penale, per lajmet e publikuara kunder organeve shteterore, personave private e publike, kombetare e nderkombetare qe nuk jane te mbeshtetura ne fakte e prova objektive.

- Administratori shoqerise nuk mund:

- i) te lidhe kontrata ne emrin e shoqerise me veten, familjare te tij, farefisin e tij, bashkeshorten, femijet, krushqine dhe shoqerine e tij. Nga ky rast bejne perjashtim ato kontrata qe te cilat sjellin perfitim ekonomik konkret e real, per shoqerine.
- ii) te transferoje para nga llogarite e shoqerise ne llogarite e familjarve te tij, farefisit te tij, bashkeshortes, femijeve, krushqine dhe shoqerise se tij.
- iii) te terheqe para ne dore nga llogarite bankare te shoqerise apo te pranoje pagesa ne para nga persona me te cilet shoqeria kryen veprimitari tregtare.
- iv) te miratoje publikimin e lajmeve dhe/ose informacione te gabuara, te pasakta, fallco apo te rreme per llogari te shoqerise apo te lejoje qe stafi qe ai do mbikqyre te beje nje gje te tille. Nese ky fakt ndodh perjegjesine financiare dhe administrative per kete gje e mban administratori.
- v) te shese apo bleje asete te shoqerise, pasuri te luajtshme e te paluajtshme te shoqerise pa miratimin me vendim te shkruar te ortakut themelues.
- vi) nuk mund te perhaje lajme denigruese, shpifese, te paverteta apo qe cenojne imazhin e shoqerise gjate kohes qe eshte ne funksionin e Administratorit si dhe pas perfundimit te ketij funksioni.
- vii) te pervesoje ose marri informacione konfidenciale, shkresore, te shkruara, ne format elektronik dhe as te shperndaje ne asnje lloj rruge si me botim ne internet, lajme audio pamore, emisione radiofonike ose televizive informacione konfidenciale. Nga ky rast bejne perjashtim rasti kur kjo i kerkohet nga organe si prokuroria.
- viii) nuk mund te mbaje funksione gazetari, punonjesi te thjeshte, administratori ne shoqeri te tjera qe kryejne funksione te njeta, te ngjashme apo qe i perafrohen atyre te shoqerise,
- ix) te japi miratimin publik ose te botoje lajme te paverteta, fallco, me mangesi apo te paverifikuara me fakte konkrete, ne rast te kundert mban perjegjesi per keto botime perpara organeve perjegjese. Nese per veprimet apo mosveprimet e tij shoqeria gjobitet per shkaqet e dhena ne kete pike kjo gjobe shlyhet nga administratori me te ardhurat personale.
- x) te japi miratimin publik ose te botohen lajme qe permbajne ne menyre te terthorte, drejtperdrejt apo me nenkuptime mesazhe urrejtje, rracizmi, kunder apo pro fese, ne favor te çfaredo forme terrorizme, kunder rendit ligjor.
- xi) te japi miratimin publik ose te botoje lajme pro ndonje krahu politik apo lajme qe kane si qellim perkrahjen e ndonje feje.
- xii) te marri kredi, borxhe apo hua ne emer te shoqerise nga subjekte bankare, jo bankare, mikro finance, si dhe çdo lloj personi. Marrja e kredive, borxheve e huave do kryhet vetem me kunderfirmsen, ne te njejten kohe e vend, te ortakut te vetem.
- xiii) nuk mund te marre lajme te gatshme nga persona te trete te pavarur ose jo, qe nuk jane te verifikuar nga administratori per vertetesine e tyre.



6

xiv) te boteje reklama politike, fetare, kunder rendit ligjor, per demtimin e shendetit, qe demtojne te miturit dhe mirqenien e tyre psikologjike e fizike, per shitjen e farmaceutikeve qe jepen vetem me rekomandimin e mjekut, pro duhanit, kunder te drejtave te njeriut, qe favorizojne terrorizmin e çdo lloj fushe, rraciste, diskriminuese.

#### DREJTIMI TEKNIK I SHOQERISE

##### NENI 23

Per veprimtari ne fusha te veçanta (ne te cilat ligji percakton drejtim nga specialistet te licensuar), shoqeria do te punesojeme kontrata pune specialist te licensuar sipas fushes perkatese.

#### MARRDHËNIET FINANCIARE

##### NENI 24

Shoqeria ka të drejte të hape llogari rrjedhëse, kursimi e depozite prane bankave te vendit ose te huaja në shteterore ose private dhe të kryeje veprimet e likujdimit të furnitorëve të saj e të paguhet, për shërbimet që ofron, nëpermjet tyre. Per sigurimin e veprimitarise ka te drejte të financohet në leke ose valute te huaj.

##### NENI 25

Shoqëria pergjigjet për kontributet fiskale, sigurimet shoqërore dhe afatet e derdhjes së tyre. Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacion te rregullt finanziar.

Ne fund te vitit finanziar, Administratori duhet te dorezoje pranë organeve tativore perkates bilancin e të ardhurave per efekt të tatimit vjetor.

Viti finanziar mbaron ne muajin dhjetor te çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionin ne fuqi.

#### MARRDHENIET E PUNESIMIT

##### NENI 26

Administratori vendos për personat qe do punësohen në aktivitetin e shoqerise. Punësimi do bëhet në përputhje me aftesite profesionale te punemarresit.

##### NENI 27

Marrdhëniet e punesimit do regullohen sipas kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve, ne baze të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nenligjore në fuqi. Në kontrate caktohen kushtet e punes, pageses, sigurimit në pune, diteve te pushimit etj.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'AD' or a similar monogram, is placed here. To its right is a small number '7'.

## NENI 28

Ortaku, Administratori dhe personeli i shoqërise është i detyruar të respektoje disiplinen e punës, të ruaje dhe të mirmbaje pronen dhe te zhvilloje aktivitetin e shoqerise ne perputhje me ligjin. Çdo punonjes i shoqërise është përgjegjes për kryerjen e detyres, e permbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit. Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masat disiplinore të parashikuara nga Kodi i Punës.

## KONFIDENCIALITETI

### NENI 29

Të gjithë personat e punësuar në shoqeri janë të detyruar të ruajne fshehtesine e dokumentacionit, të informacionit, të njojurive të fituara si dhe të çdo lloj materiali tjeter konfidencial, me përjashtim të rastit kur këto informacione janë të jashtligjshme, shkelin normat e moralin e përgjithsëm të shoqërise apo përbëjnë veper penale.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

### NENI 30

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve ndaj personave të trete, kalojne ne dispozicion të ortakëve.

### NENI 31

Pagesat e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore të personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punës.

### NENI 32

Në rast mbarimi të veprimitarise së shoqërise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar perqindjet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojne në dispozicion të ortakeve sipas mases së kuotave që zoterojne në shoqeri.

## PËRFUNDIMI SHOQËRISE

### NENI 33

#### Shkrirja

Shoqëria mbaron me te perfunduar afati i parashikuar nga ky akt ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, me ane të një vendimi të asamblese së përgjithshme dhe per shkak të falimentimi.

**NENI 34  
Likujdimi**

Në rast përfundimi, shoqëria do ti nënshtrohet procedurave të likujdimit. Për të administruar këtë procedure, asambleja e përgjithshme e ortakeve emeron një ose disa likuidatore, të cilet paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqërise, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen e nevojshme për të përfunduar likujdimin.

**NENI 35**

Shoqëria mund të mbaroje edhe me anë të riorganizimit, nepermjet formave te thithjes ose të bashkimit duke marre miratimin e Ministrise se Energjise dhe Industrise.

**NENI 36**

Gjate fazes se likujdimit, pergjegjesia e administratorëve dhe likuidatorit është e njëjtë.

**DISPOZITA TE FUNDIT**

**NENI 37**

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, plotësimi dhe drejtimi i veprimeve bëhet duke iu referuar Ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret" i ndryshuar, si dhe çdo akti tjeter në fuqi të legjislacionit shqiptar.

**NENI 38**

Ky statut u përpilua nga ortaku themelues i shoqërise me vullnetin e tij të plote e të lire.

Statuti u hartua në dy kopje të njëjta, në përbajtje e fuqi ligjore, ku një kopje do të dorëzohet pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërise.

**Tiranë më 14.10.2022**

**ORTAK I VETEM I SHOQERISE**

**Juljan Hysenaj  
Administrator**

